

**Dorëheqja
dhe sëmundja**

**Sigurimi i pagës
në rast sëmundjeje**

2

**Të rinjtë pa
leje qëndrimi**

**Mundësohet arsimimi
i tyre profesional**

3

**Përmbyllja
e pagave 2013**

**Përmirësime në
sektor të ndryshëm**

4

Nr. 1 | janar 2013 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

U mbajt Kongresi i rregullt i sindikatës Unia

Fillon një periudhë e re

Nga 29 nëntor deri më 1 dhjetor në Cyrih u zhvillua Kongresi i rregullt. Delegatët e Unia-s ndër të tjera kanë zgjedhur drejtorinë re qendrore dhe kanë përcaktuar orientimet e punës sindikaliste. Ne vijim do t'u informojmë për zhvillimet tjera të punimeve në kongres.

Bashkëkryetari i Unia-s, Renzo Ambrosetti te 400 delegateve dhe të 300 mysafireve pjesëmarrës të Kongresit në fillim ua komunikoj lajmin se «Unia është rritur në vitin 2012 dhe atë sikur jo me herët». Ndërsa Andreas Rieger, ish bashkëkryetari tjetër i Unia-s, në fjalën e tij të hapjes theksojë sukseset politike e sindikaliste të Unia-s në katër vitet e fundit, si p.sh. mbrojtja e vjedhjes së pensioneve të kolonës së dytë apo përmbyllja e Kontratave Kolektive të Punës(KKP), si ajo për personelit të huazuar.

Protestë para ministrit mysafir Berset

Në fjalën e tij përshëndetëse drejtuar Kongresit ministri i qeverisë zvicerane Alain Berset iu falënderua sindikalistëve për punën e tyre të rëndësishme për demokracinë. Ai ndanë me ta qëllimet e përbashkëta për të garantuar sigurinë sociale. Një grup i përzier sindikalistësh aktiv para tij shprehën pakënaqësinë tyre në formë proteste, pasi që Enti Federal për Sigurimet Shoqërore kundërshton edhe më tej zbatimin e Marrëveshjes për Sigurimet Shoqërore me Kosovën edhe përkundër vendimeve të plotfuqishme gjyqësore, dhe pos kësaj u protestua kundër planeve të paralajmëruara për rritjen e moshës së pensionit në 65 vjet për gratë.



Peshku gjigant i formuar nga 500 çadra të kuqe ndjek dhe përpinë simbolikisht peshkaqenin

Një migrante e gjeneratës së dytë si bashkëkryetar!

Në ditën e dytë të punimeve të Kongresit u zgjodhën Presidiumi dhe drejtuesit e sindikatës: Delegatët rizgjodhën bashkëkryetarin Renzo Ambrosetti dhe si bashkëkryetar u zgjodh Vania Aleva. Kjo paraqet një të arritur të dyfishtë, pasi për herë të parë një grua njëherazi edhe mi-

grante e gjeneratës së dytë zgjidhet të drejton sindikatën më të madhe të Zvicrës. Gjithashtu në drejtorin qendrore janë zgjedhur kandidatët e propozuar nga seksionet e Unia-s Corrado Pardini (sektori i Industrisë), Nico Lutz (sektori i Ndërtimit kryesor), dhe Aldo Ferrari (sektori i Zejtarisë), përgjegjës i ri për financa u zgjosh Martin Tanner, si dhe Rita Schiavi, Corinne Schärer dhe Pierluigi Fedele.

Aksioni «Peshku ndjek peshkaqenin»

Të premtën paradite u zhvillua një aksion proteste në sheshin «Paradeplatz». Të armatosur me 500 çadra të kuqe, në të cilat ishin të shtypur peshq të bardhë, pjesëmarrësit e Kongresit në sheshin e Bankave formuan mizëri gjigant në formë peshku, i cili simbolikisht përpinë një peshkaqen. Në vendngjarje protestuesit kritikuan abuzimet e menaxherëve të lartë dhe të Bankave. Ata kërkuar një ndarje të drejtë të të ardhurave dhe një pagë minimale prej së paku 4000 frangave.

Pensionet e të moshuarve, mbrojtja e aktivistëve dhe migracioni

Gjatë kongresit i diskutuan dhe u aprovuan edhe qëndrimet mbi përkujdesjen sociale të të moshuarve dhe lëvizjet migruese. Iniciativa e SGB-së (Unionit të Sindikatave Zvicerane) për ngjitje 10 të pensioneve të pleqërisë u mbështet dhe aprovua nga delegatët e Unia-s. Pastaj delegatët vendosën pikësnyimet e veprimtarisë të sindikatës Unia për katër vitet e ardhshme. Ndër prioritetet e rëndësishme me këtë rast u formuluan fuqizimi i mbrojtjes së sindikalistëve aktiv nëpër ndërmarrrje. Kongresi ngarkoi strukturat e Unia-s që të iniciojë një referendum popullor për të garantuar mbrojtjen e aktivistëve sindikal. Pikësnyime tjera ndër të tjera janë përmirësimi i Kontratave të Përgjithshme të Punës, një politikë aktive ekonomike dhe sociale si dhe politikë të drejtë migracioni.

Editorial



Të dashur/a lexues/e

Viti i ri 2013 për sindikatën Unia ka edhe domethënien e një periudhe të re të Kongresit. 8 vite pas bashkimit sindikata jonë ka arritur të konsolidohet si një njësi dhe të ndaloj humbjen e anëtarësisë si dhe të stabilizohet. Pas Kongresit në Cyrih ne tani kemi përcaktua qëllimet e reja për katër vitet e ardhshme (shih krahas edhe artikullin kryesor). Qëllimi ynë kryesor do të jetë që Unia-na ta bëjmë sindikatë të personave të besuar (aktivistëve). Politikisht gjendemi përballë sfidash të mëdha: Iniciativa për pagën minimale, për të cilën do të votohet vitin e ardhshëm, lansimi i iniciativës AHJV+ këtë vit, apo referendumi kundër liberalizimit të orarit të punës nëpër shitore. Pos kësaj këtë vit do të zhvillohen edhe bisedimet me rëndësi të madhe për Kontratën e Përgjithshme të Punës për sektorin MEM (Makineri Elektricitet dhe Metal).

Edhe sa i përket politikës së migracionit na presin kohë të vështira: Iniciativa e SVP-së «Ndal migracionit masiv», si dhe referendumi kundër revidimit të Ligjit për Azil, i cili është dorëzuar në muajin janar, do të na detyrojë në të mbrohemi nga sulme e partive të djathta. Mirëpo ne jo vetëm se do të udhëheqim një luftë mbrojtëse, porse ne duhet që me synime e iniciativa të qëllimta dhe hapa konkret të angazhohemi për të drejtat e migrantëve dhe migrantëve. Qëllimi ynë kryesor me këtë rast mbetet arritja e participimit politik dhe eliminimi i çfarëdo diskriminimi, posaçërisht në botën e punës.

Pra kemi për të bërë shumë punë, të cilat kërkojnë forcën e të gjithë neve. Bashkë jemi më të fortë!

Aurora Garcia

Sekretare për migracion dhe anëtare e redaksisë



Dy bashkëkryetarët e zgjedhur nga Kongresi

© Aurora Garcia

News

Qeveria refuzon Inicativën e SVP-së



Në fillim të dhjetorit qeveria zvicerane ka marrë qëndrim mbi Inicativën «kundër migracionit masiv» të SVP-së. Kjo iniciativë donë përsëri migranteve e migrantëve ti diskriminojë dhe tua shkurtojë të drejtat, të cilat janë përmirësuar falë marrëveshjeve bilaterale. Sindikata Unia mbështet qëndrimin e qeverisë, se Iniciativa është e dëmshme dhe paraqet sulm karshi të drejtave të migrantëve, andaj edhe duhet refuzuar.

Bisedimet për KPP të përkujdesjes private jo-mjekësore

Shoqate krijuar rishtas «Të jetosh në shtëpi» dhe sindikata Unia në fund të vitit 2012 kanë filluar bisedimet për Kontratën e Përgjithshme të Punës për këtë sektor të përkujdesjes private jo-medicinale të personave të moshuar në Zvicrën gjermano folëse. Kjo Kontratë duhet të mbrojë si kushtet e punës ashtu edhe kualitetin e përkujdesjes për këtë lëmi me rëndësi në shtim e sipër.

Gjyqi i jep të drejtë padisë kundër pagave të Euros



Në një vendim të instancës së dytë Gjyqi Kantonal në Listal më 17 dhjetor 2012 e ka vlerësuar të drejtë padinë e gjashtë ish punëtorëve të Firmës «Stöcklin AG» të Aesch-it. Stöcklin ka larguar punëtorët nga puna, pasi ata nuk u pajtuan me një shkurtrim prej 6% të të ardhurave për kalimtarët e kufirit. Vendimi krijon qartësi juridike, e cila tani duhet të respektohet edhe nga Firmat tjera në Zvicrën veriperëndimore si dhe në zonat tjera kufitare.

Dorëheqja dhe Sigurimi i parave ditore në rast sëmundjeje (KTGV)

Dorëheqja në rast sëmundjeje



Punëtori i ndërtimtarisë Bruno Dos Santos pak kohë pas një mungese për shkak sëmundjeje dëbohet nga puna. Edhe pse Unia dorëheqjen e ve në pikëpyetje, sigurimi kundërshton të vazhdojë të paguajë pagën. Gati plot 2 vjet ai lufton për të drejtat e tij.

Pa dëshirën e tij Bruno Dos Santos në mëngjesin e një dite nëntori para më se dy vitesh rrinë në shtëpi, kur ai pa paralajmërim merr shkresën e prishjes së kontratës së punës. Portugezi 27 vjeçar për javët vijuese posedonte dëshmi sëmundjeje, pasi ai për shkak të një sëmundjeje të rëndë dhe pas një operacioni po kurohej.

Letra e diskutueshme dorëheqëse

Babi i dy fëmijëve shpejt telefonon këshilltarin e tij nga firma temporale, i cili e qetëson dhe e sqaron, se dorëheqja ka të bëjë vetëm me vendin e tij të punës në kantier, ku ai ishte ndërmjetësuar nga kjo firmë, mirëpo nuk kishte të bënte me firmën temporale. Ai pas kësaj nënshkruan dorëheqjen dhe ia kthen punëdhënësit. Me këtë rast atij i shpëton të shihet, se dokumenti i shkruar kishte datën e një muaji më parë. Pos kësaj shkresa nuk thoshte asgjë mbi afatet e dorëheqjes dhe në cilin termin Dos Santos do të përfundonte punën.

S'ka pagë, s'ka para ditore në rast sëmundjeje

Në fund të vitit 2010 Das Santos i ende në kurim dhe i paaftë për punë, se

ai nuk kishte marr rrogën në konton e tij. Në pyetjen e tij firma temporale përgjigjet, se atij i është dhënë dorëheqja në tetor dhe se për këtë arsye ai nuk kishte të drejtë të merr rrogë për muajin dhjetor. Pos kësaj mungonin edhe përfitimet nga kontributet e sigurimit të pagës ditore në rast sëmundjeje, edhe pse ai ishte i sëmurë derisa ende punonte. Das Santos si anëtar i sindikatës që ishte, kërkoi të këshillë nga shërbimi i këshillimores juridike të sindikatës Unia.

Padia ndryshon situatën

Vlerësimi i gjendjes faktike për këshilltarin juridike të Unia-s, Susana Pereira rezultoi se, Dos Santos nuk do të duhej të ti jepej dorëheqje nga puna, pasi që ai qysh gjatë kohës sa ishte i punësuar ishte sëmurë. Kontrata e përgjithshme Vendore e Punës për ndërtimtarin (LMV) parasheh për punëtorët e sëmurë të ndërtimtarisë një mbrojtje nga dorëheqja prej maksimalisht 720 ditësh. Andaj Sigurimi i pagës ditore në rast sëmundjeje (KTGV) do të duhej pa vonesë të kompensonte atë. Këshilltarja juridike në ditën vijues kontaktoj punëdhënësin, i cili ngulte këmbë në dorëheqje. Këshilltarja juridike më

pastaj paditi punëdhënësin në Gjyq për parregullsi dorëheqjeje. Për mëtejherë lëvizi puna. KTGV-ja pagoi nga 1 shkurti e këtej. Si duket dalja para Gjyqit ishte shkak që Sigurimi të rivlerësonte edhe njëherë gjendjen faktike të rastit.

Procedura gjyqësore stërgjatë

Me koncesionin e Sigurimit ishte zgjedhur vetëm një problem, pasi

KTGV-ja paguante vetëm deri më 1 shkurti 2011 duke përfshirë edhe muajt e kaluar. Për pagat e muajve dhjetor dhe janar konteksti juridik kishte të bënte me punëdhënësin. Gjyqtari përgjegjës i dha të drejtë Dos Santos dhe dënoi firmën tepore për të paguar pagat e muajit dhjetor dhe janar. Edhe përkundër kundërshtisë fillestare firma megjithatë në fund bëri pagesën.

Per Johansson

Informatat në vijim kanë të bëjnë me çështjet kur punëdhënësi i jep dorëheqje punëmarrësit.

Shkresa dorëheqëse:

Ligji parasheh si duhet të bëhet dorëheqja. Ajo mund të bëhet me shkrim, mirëpo edhe me gojë, apo edhe vetëm me një mesazh përmes SMS-i. Normalisht dorëheqja punëmarrësit i dërgohet me shkrim dhe atë me postë rekomande. Kështu në rast kontestimi mund të vërtetohet koha e dorëheqjes. Më së miri është nëse personi i prekur ruan shkresën bashkë me zarfin e dërguar, pasi që vula postare në zarf në rast konteksti krijon shpesh qartësi. Një dorëheqje e rregullt përmban terminin e përfundimit të kontratës dhe afatet e dorëheqjes, në bazë të së cilës mund të nxirret përfundimi se deri kur punëdhënësi ka të drejtën e marrjes së pagës.

Afatet e dorëheqjes:

Nëse punëdhënësi prish kontratën e marrëdhënies së punës, punëmarrësi ka të drejtën e marrjes së pagës në afatet vijuese të dorëheqjes. Afati i dorëheqjes në të shumtën e rasteve vlen, për të pasur mundësi punëmarrësi të shihet për vend të ri pune. Ka afate të ndryshme dorëheqjeje. Gjatësia e afateve të dorëheqjes varet sipas ligjit të punës (OR = të Drejtës Obliguese) nga koha e marrëdhënies në punë. Pos kësaj afatet e dorëheqjes mund të jenë të ndryshëm në kohë varësisht nga Kontratat e Përgjithshme të Punës.

Dorëheqja në rast sëmundjeje:

Një punëmarrës sipas rregullit në rast sëmundjeje nuk lejohet të përjashtohet nga puna. Në përgjithësi Ligji i Punës (OR) parasheh afatet e kushtëzimit prej së paku 30 ditësh. Varësisht nga stazhi i punës ky afat mund të jetë më i gjatë. Edhe Kontratat e Përgjithshme të Punës parashohin në bazë të sektorit kushtëzime të ndryshme kohore.

Nëse një punëmarrës është i sëmurë apo vuan nga aksidenti, afati i dorëheqjes zgjatet për sa kohë zgjat sëmundja, mirëpo maksimalisht sa janë kushtëzimet kohore të përmendura më lartë. Duhet pasur parasysh se, në kohën e punës provuese vlejnjë tjera rregulla.

Sigurimi i pagës ditore në rast sëmundjeje (KTGV)

Ligji i Punës (OR) nuk parasheh obligim të përgjithshëm për punëdhënësin sa i përket lidhjes së kontratës për Sigurimin (KTGV) në fjalë. Nëse një punëmarrës gjatë marrëdhënies së punës sëmurët, vlejnjë kushtëzimet kohore të lartshënuara, në të cilat nuk lejohet përjashtimi nga puna. Në raste të caktuar në sektor të ndryshëm parashihet që punëdhënësi të lidhë kontratë me Sigurimin (KTGV) në fjalë. Nëse një i punësuar gjatë marrëdhënies në punë sëmurët, Sigurimi (KTGV) duhet për kohë të caktuar të paguajë pagën. Kalimi nga sigurimi kolektiv në fjalë në sigurimin individual është i mundur për punëmarrësit. Kalimi duhet të ndodh brenda 90 ditësh prej përfundimit të afateve të dorëheqjes.

Në rast pyetjesh mbi shkresën e dorëheqjes apo të Sigurimit (KTGV) në fjalë ndihmohet këshilltarët e sekretariatit të Unia-s Tuaj.

Susana Pereira, Këshilltare juridike në Unia Cyrilh



Bruno Dos Santos fitoi falë mbështetjes së Unia-s

Aftësimi profesional për të rinjtë pa letra

Rregullorja bënë të mundshëm arsimimin profesional për të rinjtë pa letra

Të rinjtë pa letra (Sans-Papiers) në Zvicër që nga 1 shkurti 2013 mund të vijnë në mesimin profesional. Qeveria e vendit më dhjetor 2012 ka publikuar një Rregullore, e cila nga sindikatat dhe kolektivet e personave pa letra ka kohë që është kërkuar për tu zbatuar.

Fëmijët e personave pa leje të rregullt qëndrimi, të cilët shumicën e kohës së fëmijërisë dhe rinisë e kanë kaluar në Zvicër, nga 1 shkurti 2013, pas përfundimit të shkollimit obligues, mund të fillojnë mesimin të zejes së punës. Ndryshimin e caktuar të Rregullores mbi lejimin, qëndrimin dhe punësimin (shkurtesa në gjermanisht: VZAE) e ka publikuar Qeveria në fillim të dhjetorit të vitit të kaluar. Me këtë përmbushet kërkesa e mocionit të parlamentarit Luc Barthassat të vitit 2010.


Parakushtet për mesimin e profesionit

Neni i ri 30a i VZAE thotë se për të përfunduar një profesion, gjegjësisht për të marrë lejen e qëndrimit për kohën që zgjat arsimimi profesional, të rinjtë Sans-Papiers (pa letra) duhet të jenë "të integruar mirë", d.m.th. të zotërojnë një rreth prej gjuhëve zyrtare të vendit dhe të respektojnë rregullimin ligjor të Zvicrës. Pas kësaj duhet që së paku 5 vjet të kenë vijuar shkollimin e detyrueshëm në Zvicër. Gjithashtu edhe vijimi i urat e ofertave alternative të natyrës thjesht teorike janë të kushtëzuar me së paku vijim së paku 5 vjeçar të shkollimit obligues. Të rinjtë e interesuar gjithashtu du-

het të dëshmojnë identitetin e tyre legjitim tek enti apo institucione ku shtrohet kërkesa. Të rinjtë Sans-Papiers mundën brenda 12 muajsh pas përfundimit të shkollimit obligues të shtrojnë kërkesë për marrjen e lejes së qëndrimit. Pas përfundimit të arsimimit profesional Entet adekuate të Kantoneve me pëlqimin e Entit Federal për Migracion në rast e vështira të shtrojnë kërkesë për vazhdimin e lejes së qëndrimit si dhe të rregullojnë qëndrimin e prindërve dhe vëllezërve motrave të tyre.

Kritikat mbi Rreguloren

Në të vërtetë përkrahësit e mesimit të profesionit për të rinjtë Sans-Papiers janë të kënaqur, që kjo është bërë e mundshme, megjithatë ka edhe kritika për Rreguloren. Kështu Platforma kombëtare për Sans-Papiers, një bashkim i gjerë ky i organizatave joqeveritare dhe këshillimoreve vendore, të cilave iu është bashkuar edhe Unia, kritikojnë se qasja për mesimin e profesionit theksohet si mundësi e jo si e drejtë e patjetërsue hme. Problematike është edhe se procedura e leje-qëndrimit zgjat më shumë se do të duhej. Këtu shprehet në fleksibilitet të caktuar nga ana e punëdhënësve potencial.



Të rinjtë pa letra (Sans-Papiers) fitojnë të drejtën e aftësimi profesional

Megjithatë një hap në drejtimin e duhur

Deri më tani këta të rinj pas përfundimit të shkollimit obligues nuk kishin asnjë perspektivë. Zakonisht atyre u duhej të qëndronin edhe më tej të fshehur dhe mundësisht të punonin në të zejë. Me ndryshimin e Rregullores këta të rinj tani kanë

mundësinë të vijnë në mesimin e profesionit. Aftësimi profesional në çdo rast atyre mund t'ju hyjë në punë, qoftë nëse ata pas mesimit të profesionit qëndrojnë në Zvicër, apo edhe nëse ata duhet të kthehen në vendet e tyre amë. Aftësimi profesional u hap atyre perspektiv të vërtetë.

Unia tani kërkon nga punëdhënësit të bashkëpunojnë për zbatimin praktik të Rregullores në fjalë dhe gjatë dhënies së vendeve të mesimit të profesionit për vitin që hymë të kenë parasysh edhe të rinjtë Sans-Papiers.

Aurora García

Liberalizimi i orarit të punës të shitoreve

Jo punës 24 orësh në ditë: Është lansuar referendumi



Kufizohet jeta familjare e sociale edhe në fundjavë

Më 14 dhjetor 2012 Parlamenti ka vendosur përfundimisht, të zgjohet orari i punës nëpër shitoret e pikave të karburantit. Ky vendim për Aleancën e së dielës, të cilës i takon edhe Unia, është i papranueshëm. Ai qon në zgjerimin e orarit të punës të dielave dhe futja e punës së pandërprerë 24 orësh në tregtimin me pakicë, që me veti bie pasoja të rënda për të punësuarit dhe shoqërinë. Më 8 janar përmes një konference për media u shpall fillimi i Referendumi kundër liberalizimit të orarit të punës.

Liberalizimi nëpër pikat e karburantit gjendet në fillim të një zhvillimi të rrezikshëm: Qysh tani treguesit me pakicë kritikojnë përjashtimet karshi shitoreve nëpër pikat e karburanteve dhe kërkojnë pjesën e njëjtë

të kulaçit. Iniciativa të caktuara janë plasuar në Parlament. Kështu në ditët e kaluara në Këshillim federal është aprovuar një mocion, ku kërkohet që puna të dielave të mundësohet për të gjithë.

Rrezikohet jeta sociale dhe shëndeti

Pasojat do të ishin të rënda dhe nuk do të prekin vetëm sektorin e tregtimit me pakicë, porse të gjithë të punësuarit: Puna të dielave dhe natën rrezikojnë vendet ekzistuese të punës, janë dëshmuar të vështirësojnë ndjeshëm jetën sociale dhe atë familjare. Për të penguar përkeqësimin shoqëror dhe për të ndaluar zgjerimin e punës të dielave është lansuar Referendumi nga ana e Aleancës e së dielës, të cilës i takon edhe Unia.

Aurora García

Fletët për nënshkrim mund ti merrni në sekretariatet e Unia-s, apo nga faqja e internetit: <http://sonntagsallianz.ch/referendum/> e të cilat të nënshkruara duket të dërgohen pas deri më 15 mars 2013.



Përgjegjësi të përbashkëta

Sukses i sindikatave dhe punonjësve



Më 14 dhjetor Parlamenti ka diskutuar edhe përgjegjësinë solidarë dhe ka vendosur mbi përgjegjësitë e përbashkëta. Punëmarrësit dhe sindikata Unia kanë punuar gjatë për këtë vendim dhe janë të kënaqur. Tani vlen garantimi i zbatimit efektiv të përgjegjësisë solidarë për të mënjanuar suksesshëm shtypjen e pagave dhe që ligji të mos dobësohet.

Futja e përgjegjësisë së përbashkët tani më është vendosur përfundimisht. Këshilli dhe parlamenti federal tani më me votimin përfundimtar kanë vërtetuar përgjegjësinë solidarë. Në të ardhmen ndërmarrjet janë përgjegjëse, nëse njëra nga ndërmarrjet nënkontraktuese nuk iu përmbahet komizave të përcaktuara zvicerane, sa i përket pagave dhe ligjeve të punës.

Peticioni i Unia-s ka kontribuar suksesshëm

Sindikata Unia përshëndet këtë vendim. Ai është një hap i rëndësishëm kundër dumpingut të pagave. Mbi 27000 punëmarrës të ndërtimtarisë dhe zejtarisë në vjeshtën e kaluar

kanë nënshkruar peticionin për futjen e përgjegjësisë së përbashkët, gjë që Unia ka kohë që e kërkon me këmbëngulësi aprovimin e këtij instrumenti.

Zbatim efektiv, jo dobësim

Tani është fjala që përgjegjësia solidarë të zbatohet detyrueshëm dhe kjo të stabilizohet si instrument efektiv kundër dumpingut të pagave. Sindikata Unia do të kundërshtojë çdo përpjekje të mundshme kundër dobësimi të përgjegjësisë solidarë dhe kundër instalimit të pengesave të panevojshme burokratike me rastin e zbatimit.

Aurora García

Risit e pagave të negociuara për vitin 2013

Pagat e përmbyllura

Sector	Empresa	Aumento	Aumento general	Aumento individual	Observaciones
Industria MEM	Amcor, Kreuzlingen (TG)	1,7%	-	1,7%	Plus 0,3 Përshatje strukturore e pagave minimale
	Burckhardt Compression, Winterthur	1,1%	0,7%	0,4%	Më së paku Fr. 60.- përgjithësisht
	Busch, Pruntrut JU	1-1,5% **	40.-/60.-	-	Fr. 60.- në pagat deri 4000.-, Fr. 40.- nga 4000.-, rritje e shtesës për punë në turne për 5%
	Hoffmann Neopac, Thun	0,5-1,5%**			1,5% përgjithësisht për punëtorët në turne, 0,5% individualisht për të tjerët
	Maag Gear, Winterthur	1,5%	1%	0,5%	
	Siemens	1%	-	1%	
	Sulzer, Winterthur	1%	-	1%	
Industria e Ndërtimit	Ndërtimtaria kryesore	0,5%	0,5%		Plus 0,5% në pagat minimale
	Gleisbau	1%	1%		Plus 1,5% në pagat minimale
Kimia	CABB, Pratteln BL	0,8%	-	0,8%	
	Cilag, Schaffhausen	1,5%	-	1,5%	
	Roche	1,4%	70.-	Rest	
Industria ushqimore dhe jo shijuese	Camille Bloch, Courtelary BE	1%	45.-	0,25%	
	Feldschlösschen, Rheinfelden AG	0,3%	-	0,3%	Unia ka refuzuar ofertën
	Fenaco	0,8%	-	0,8%	Unia ka refuzuar ofertën
	Hero, Lenzburg AG	-	-	-	Fr. 250.-, Unia ka refuzuar ofertën
	Lindt & Sprüngli, Kilchberg ZH	1,5%	-	1,5%	Në pagat deri Fr. 5000.-, Reduktimi i premive PK 5%
Ekonomi ndërtimi dhe zejtar	Veprimtari e zgjëruar	0			
	Veprimtari e zgjëruar BS	1,2%**	60.-	-	
	Ndërtim karrocierie	0,8%**	-	-	Plus Fr. 75.- në pagat minimale
	Tavanpunues dhe ndërtim sistemesh të brendshme	0,6%**	-	30.-	
	Tavanpunues dhe ndërtim muresh	0,6%**	-	-	Premi e njehershme nga 1,25%, nga to 0,75% përgjithësisht, plus Fr. 30.- paga minimale
	Punë elektriciteti	1,5%	-	1,5%	
	Teknikë ndërtesash	1%	-	1%	Unia ka refuzuar ofertën
	Punë me gips BS	0,7%	0,5%	0,2%	
	Ndërtim me lëndë drusore	0,8%**	-	-	Plus Fr.90.- / 100.- paga minimale, plus Fr. 3.-/ 10.-/20.-për shqert plus Fr. 2.- për ushqim
	Ndërtim izolimi	0			
	Ndërtim metali dhe makinash bujqësore	0			S'ka përmbyllje pagash
	Ndërtim metali BL	0,5-1%	0,5%	0-0,5%	0,5% individuale nëse mundësohet
	Shtirim pllakash	0,8%-1%**	40.-	-	
	Zdrukhëtari	0			
Terciar	Aldi	0,8%	0,8%		Plus 2% në paga minimale
	Bardusch	0,7%**	25.50	-	Plus pagesë e njehershme & rritje e pagave minimale Fr. 100.-
	Coop	1,1%	0,6%	0,4%	Plus rritje e pagave minimale 100.- në 2 nga 3 kategoritë
	Denner	0,8%	0,3%	0,5%	
	Kantonsspitaler AG	1,4%			
	Gastronomi	-	-	-	Pagat minimale nga viti 2014 do të barazohen me shtrenjtimin
	Elvetino	1,3%	50.-	-	Plus rritje të pagave minimale Fr. 25.-, sistem i ri pagash me paga më të mira dhe më shumë ditë të lira
	Migros	0,5-1%	-	0,5%-1%	
	Pastrimi në Zvicrën gjermano-folëse	2%**			Rritje të pagave minimale 1-2,5%
	Pastrim në Zvicrën frazë-folëse	2%**			Rritje të pagave minimale 1,8-2,4%
	Sektori i sigurimit	1,2%**			Rritje automatike sipas shkallës së pagave nga 0,6-3,2%, plus rritje të pagave minimale 1-1,3%
	Spar	0,5-1%		0,5-1%	
	Volg	0,8%	0,8%		



Ju pyesni, Unia përgjigjet



Çka duhet të zgjedh unë: Pensionimin e mëhershëm apo kompensimin?

Unë punoj qe shumë vite si këshilltar i myshterinjve për një bankë. Shefi im nuk është më i kënaqur me kontributin tim dhe me ka vu para situatës ku duhet të zgjedh: Ose unë të prishi marrëdhënien e punës menjëherë dhe përfundimisht dhe si kompensim do të marr 40 000 franga. Apo unë pas disa muajsh, kur ti mbushi 57 vjet të dali në pension të parakohshëm. Çfarë ndikimi kanë këto dy variante në kompensimin e papunësisë?

Të dy variantet me veti bartin pjesërisht pasoja të rëndësishme përkitazi me të drejtën tuaj për kompensim nga arka e sigurimit të papunësisë. Nëse vendosni për pensionim të mëhershëm, atëherë nuk keni fare të drejtë në kompensim nga arka e papunësisë. Mirëpo ka një përjashtim. Në ligjin për sigurimit të papunësisë qëndron: Nëse jeni i papunë dhe nëse vullnetarisht pranoni pensionimin para arrijtes së moshës së pensionimit të rregullt, mund të paraqitni kërkesën për kompensimin në arkën e sigurimit të papunësisë, vetëm nëse keni filluar përsëri të punoni. Dhe këtë në kohëzgjatje prej më së paku 12 muajsh. Ndryshe qëndron puna, nëse përzgjidhni përfundimin e menjëhershëm të marrëdhënies së punës. Nëse ju gjatë afatit të humbur të dorëheqjes shtroni kërkesë për kompensim të papunësisë, arka e papunësisë do t'ju refuzojë për një kohë të caktuar të drejtën për kompensim. Mirëpo, më së gjati deri në kalimin e afatit të kushtëzuar të dorëheqjes. Pasi që deri sa kompensimi i punëdhënësit për përfundimin e marrëdhënies së punës, mbulon humbjen e të ardhurave, për këtë kohë nuk keni të drejtë të merrni kompensim nga arka e papunësisë. Kjo vlen, nëse ekziston pajtueshmëri e ndërsjellët e përfundimit të parakohshëm të marrëdhënies së punës, ashtu si është puna në rastin e juaj, nëse zgjidhni këtë variant.

work, Timur Öztürk, 4.10.2012

Paga e 13 mujore: A duhet të heq dorë?

Qe 5 vjet punoj si moler në një ndërmarrje të vogël. Krahas shefit tim dhe mua është vetëm edhe një i punësuar tjetër. Tani unë kam dhënë dorëheqje nga puna. Në fund të dhjetorit është dita ime e fundit e punës. Pasi që tani për tani kemi shumë pak porosi pune, shefi im më ka pyetur se a jam i gatshëm të heq dorë nga paga e 13-të. A është kjo fare e lejueshme?

Jo, kjo nuk është e lejueshme. Pasi që sipas Kontratës së Përgjithshme të Punës me vlefshmëri universale për moler dhe zeje gipsi është e garantuar paga e 13-të. Nëse marrëdhënia e punë gjatë vitit përfundon në mënyrë të rregullt, keni të drejtë proporcionale për pagën e 13-të. Kjo vlen edhe për rastin Tuaj. Ndërmarrja juaj duhet tua paguaj pagën e 13-të me rastin e pagesës së rrogës së fundit. Ligji në këtë rast është deri në fund i qartë. Neni 341 i së Drejtës obliguese thotë: Punëmarrësit nuk guxojnë të heqin dorë nga kërkesat, të cilat janë të vendosura me Ligje apo me rregullat e KPP-së. Kjo vlen gjatë marrëdhënies së punës dhe deri një muaj pas përfundimit të saj. Përcaktimet për pagën e 13-të sipas KPP-së për moler dhe zeje gipsi, është pikërisht një rast i tillë. Shkurt: Ju nuk duhet heq dorë nga paga juaj e 13-të.

work, Alice Niklewicz, 13.12.2012

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber Verlagsgesellschaft work AG, Zürich, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Gianfranco Helbling | Redaktionskommission A. Garcia, M. Akyol, D. Filipovic, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck Ringier Print, Adligenswil | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.

www.unia.ch